



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 48 datë 27.9.2022

**“PËR MIRATIM SHITESË PLANI NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR TË
MIRATUAR ME VKB NR. 3 DATË 05.01.2022 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT
TË VITIT 2022 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR 2022-2024 TË BASHKISË SHKODËR” I NDRYSHUAR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 27.9.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; neni 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshua ;pika 190 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; udhëzimi nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”; udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare” i ndryshuar; Kontratës së grantit me nr. ref.: EU4M-CfP1-2022/A2, datë 23.06.2022, ndërmjet “Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale së Evropës-Juglindore” – NALAS në rolin e Autoritetit Kontraktor dhe Bashkisë Shkodër ; VKB nr. 16, datë 31.03.2022 “Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2021 të Bashkisë Shkodër”; VKB nr. 33, datë 13.06.2022 “Për angazhimin e burimeve financiare të Bashkisë Shkodër për bashkëfinansim në aplikimin me nr. Ref: EU4M-CFP1-A2; për angazhimin për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes së projektit dhe për autorizimin e kryetarit për lidhjen e kontratës së grantit”; VKB nr. 3 datë 05.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër” i ndryshuar, relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër për projektin “Nxitja e përfshirjes sociale dhe zhvillimit të komunitetit”. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian nën thirrjen Skema e Granteve “BE për Bashkitë”, ku Autoriteti Kontraktor përfaqësohet nga “Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale së Evropës-Juglindore” – NALAS, dega Shqipëri. Ky projekt do të përfshihet në programin 09240 “Arsimi i mesëm profesional”, shuma 21,147,000 Lekë sipas detajimit më poshtë:

| Shpenzimet e llogaritura | | | | | | |
|---|------------|----------|------------------------|----------------------|------------------------------------|----------------------------------|
| Shpenzimet për çdo aktivitet | Totali | Nga kjo: | | | | |
| | (Lek) | Paga | Sigurim e shoq + shënd | Shpenzim e Operative | Shpenzime kapitale të patrupëzuara | Shpenzime kapitale të trupëzuara |
| Shuma 2022 | 16,917,600 | | | 730,680 | | 16,186,920 |
| Shuma 2023 | 4,229,400 | | | 4,229,400 | | |
| Shuma totale e Projektit e financuar nga programi | 21,147,000 | | | | | |

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

K R Y E T A R


Brisela KADIJA

Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 33 vota

Vota Pro 33

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 30.9.2022